



V E N D I M
K.P.P. 583/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.09.2018 shqyrtoi ankesën me: _____

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave lidhur me skualifikimin e operatorit ekonomik “Krijon” shpk nga procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-63241-04-17-2018, me objekt: Loti I “Blerje Kite”, me fond limit 2,623,850 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 07.05.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës.

Public Health Sector

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Genius” shpk, nga procedura e prokurimit mësipërcituar.

Ankimues:

“Krijon” shpk
Adresa: Rruga “Todi Shkurti”, nr. 5, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës
Adresa: “Lagjia Nr. 7”, Kukës.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë, 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, pretendimet e tij dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky operator ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

Public Health Sector

II.1. Në datën 18.04.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-63241-04-17-2018, me objekt: Loti I “Blerje Kite”, me fond limit 2,623,850 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 07.05.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës.

II.2. Në datën 07.05.2018 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 11.05.2018 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi. Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht si më poshtë vijon:

1. “Euromed” shpk	Pa dokumenta	skualifikuar
2. “Krijon” shpk	1,998,555 lekë	kualifikuar
3. “Genius” shpk	2,616,155 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 11.05.2018, operatori ekonomik “Krijon” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.5. Në datën 29.05.2018 autoriteti kontraktor ka kryer rivlersimin e procedurës së prokurimit, objekt ankimi përkatësisht si më poshtë vijon:

1. “Euromed” shpk	Pa dokumenta	skualifikuar
2. “Krijon” shpk	1,998,555 lekë	skualifikuar
3. “Genius” shpk	2,616,155 lekë	kualifikuar

II.6. Në datën 29.05.2018, operatori ekonomik “Krijon” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyen se:

S’kualifikohet sipas vendimit të komisionit të shqyrtimit të ankesave Nr.1 dt.21.05.2018 se ofertuesi duhet të ketë të paktën 1(një) inxhinier elektronik dhe 1(një) inxhinier klinik për asistence teknike, per programimin dhe funksionimin e paisjeve laboratorike në raste të demrimeve prej përdorimit të këtyre kiteve. Për inxhinierat të paraqese kopje të diplomave dhe trajnimeve si dhe listë pagesën per 6 mujorin e fundit, Ku operatori ekonomik “Krijon” shpk nuk e ka inxhinier klinik.

II.6.1. Në datën 04.06.2018, operatori ekonomik “Krijon” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor ku kundërshton vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e tij nga kjo procedurë prokurimi, si dhe kërkon skualifikimin e operatorit ekonomik “Genius” shpk me argumentat si më poshtë:

Në datë 11.05.2018 është shpallur klasifikimi në ëbsite të APP-së ku oferta jonë nuk është refuzuar.

Në datë 29.05.2018 është shpallur përsëri klasifikimi ku oferta jonë është refuzuar me arsyetimin: “S’kualifikohet sipas vendimit të komisionit të shqyrtimit të ankesave Nr.1 dt.21.05.2018 se ofertuesi duhet të ketë të paktën 1(një) inxhinier elektronik dhe 1(një) inxhinier klinik për asistence teknike, per programimin dhe funksionimin e paisjeve laboratorike në raste të demrimeve prej përdorimit të këtyre kiteve. Për inxhinierat të paraqese kopje të diplomave dhe trajnimeve si dhe listë pagesën per 6 mujorin e fundit, Ku operatori ekonomik “Krijon” shpk nuk e ka inxhinier klinik”. Referuar ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 46 pika 3 përcaktohet: “Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jetë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik”.

1- Arsyeja e refuzimit të ofertës sonë është e padrejtë pasi kompania jonë i plotëson kushtet e kërkuara për kapacitetin teknik.

2- Oferta e kompanisë “Genius” nuk është refuzuar. Ky vendim është i pa drejtë sepse kjo kompani nuk ka dorëzuar të gjitha mostrat e kërkuara në tender.

1(a)- Kompania jonë i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara në lidhje me kapacitetin teknik pika II-5 në DST. Kompania jonë ka 2 inxhinierë të diplomuar në inxhinieri elektronike. Emërtimi i diplomës bazë është inxhinieri elektronike, kurse inxhinieri klinike është një profil i

inxhinierisë elektronike. Këtë profil klinik inxhinierët e kompanisë tonë e vërtetojnë me anë të trajnimeve të realizuara dhe të vërtetuara me certifikata të kompanisë prodhuese të reagentëve në Gjermani. (Ky profil i inxhinierisë elektronike nuk ka ekzistuar dhe nuk ekziston si degë në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, përveç se një Master Shkencor 2 vjeçar pranë UPT. Sipas informacionit të marrë pranë sekretarisë së UPT, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, në këtë klasë masteri me profil Inxhinierie Klinike, numri i studentëve të diplomuar është rreth 15 të diplomuar).

(b)- Tenderi është me objekt (Objekti i prokurimit “Blerje Kite Reagente për nevojat e Spitalit Kukës e ndarë në lote, Loti 1 “ Kitë, të cilat janë materiale konsumi dhe kërkesa për inxhinier nuk është thelbësore dhe është e panevojshme. Është i pajustificuar demi ekonomik prej 617.600 lekë i cili rrjedh nga skualifikimi i pa drejtë i kompanisë tonë.

(c)- Aftësia teknike për të realizuar këtë kontratë nga ana e kompanisë tonë vërtetohet edhe me realizimin me sukses të tre kontratave që kompania jonë ka realizuar në vitin 2017 me institucionin tuaj me të njëjtin staf teknik.

2- Kompania “Genius” shpk nuk ka paraqitur të gjitha mostrat e kërkuara në tender pranë KVO-së përkatëse të ngritur nga institucioni në prani të përfaqësuesit të kompanisë tonë. Ky faktë vërtetohet nga procesverbali i mbajtur nga KVO gjatë shqyrtimit të mostrave dhe nga fotot e kryera nga po ky komision të cilat vërtetojnë mungesën e disa mostrave. Për këtë arsye kërkojmë skualifikimin e kompanisë “Genius” shpk.

Për sa më lartë argumentuam kualifikimi i operatorit ekonomik “Univers Servis” shpk bie ndesh me ligjin e prokurimit publik, ndaj kërkojmë skualifikimin e operatorit ekonomik “Univers Servis”.

II.6.2. Me shkresën nr 656 prot, datë 06.06.2018 autoritetit kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues ku ka vendosur mos pranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Krijon” shpk, nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 18.06.2018 operatorit ekonomik ankimues “Krijon” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 730 prot., datë 28.06.2018, protokolluar me tonën me numër 1134/2 prot., datë 02.07.2018, me objekt “Informacion” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Krijon” shpk, lidhur me kundërshtimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e tij nga procedura prokurimit objekt ankimi me argumentin se: *“S’kualifikohet sipas vendimit të komisionit të shqyrtimit të ankesave Nr.1 dt.21.05.2018 se ofertuesi duhet të ketë të paktën 1(një) inxhinier elektronik dhe 1(një) inxhinier klinik për asistencë teknike, për programimin dhe funksionimin e paisjeve laboratorike në raste të demrimeve prej përdorimit të këtyre kитеve. Për inxhinierat të paraqese kopje të diplomave dhe trajnimeve si dhe listë pagesën për 6 mujorin e fundit, Ku operatori ekonomik “Krijon” shpk nuk e ka inxhinier klinik”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik” Loti I, të dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar si më poshtë:

“Ofertuesi duhet të ketë të paktën 1 (një) inxhinier elektronik dhe 1 (një) inxhinier klinik për asistencë teknike, për programimin dhe funksionimin e paisjeve laboratorike në raste të demrimeve prej përdorimit të këtyre kитеve. Për inxhinierat të paraqesë kopje të diplomave dhe trajnimeve si dhe listë pagesën për 6 mujorin e fundit”.

III.1.2. Nga verifikimi i ofertës së operatorit ekonomik “Krijon” sh.p.k në sistemin elektronik të prokurimeve rezulton se për plotësimin e kërkesës së autoritetit kontraktor ka paraqitur:

- Diplomë Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni për punonjësin E. Zoga lëshuar nga Universiteti Politeknik i Tiranës.
- Diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektronike për punonjësin F. Zoga lëshuar nga Universiteti Politeknik i Tiranës.
- Listpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për periudhën tetor 2017 - mars 2018.

III.1.3. Në Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, neni 46, gërma “b” parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

III.1.4. Në nenin 53, pika 3 të LPP-së parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.5 Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 5, parashikohet si më poshtë:

“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose*
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron stafin dhe personelin e nevojshëm për përmbushjen me sukses të kontratës.

III.1.7. Nisur nga sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, për të vërtetuar se disponon punonjësit e duhur, nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor pasi ka paraqitur 1 (një) inxhinier elektronik dhe 1 (një) inxhinier telekomunikacioni, ndërkohë që autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit në kapacitetin teknik ka kërkuar dhe përcaktuar në mënyrë të qartë se operatorët ekonomik pjesmarrës për realizimin e kontratës duhet të kenë pjesë të stafit të tyre 1 (një) inxhinier elektronik dhe 1 (një) inxhinier klinik, referuar kriterit të sa më sipërcituar si dhe dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues për përmbushjen e këtij kriteri rezulton se operatori ekonomik ankimues nuk arrinë të vërtetojë se zotëron kapacitetet e nevojshme të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se nëse ankimuesi do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, ai ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës në lidhje me pretendimet e tij

parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP, ku parashikohet se: *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*. Gjithashtu, në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesave të mësipërme për kualifikim, ai mund të paraqiste kërkesë për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave të parashikuar nga neni 42 i LPPsë, ku parashikohet se: *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”*.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Krijon” shpk nuk qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik “Krijon” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që nuk i është pranuar një prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori nuk do të ndryshojë duke mbetur i skualifikuar nga procedura në fjalë, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Krijon” shpk për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-63241-04-17-2018, me objekt: *Loti I “Blerje Kite”*, me fond limit 2,623,850 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 07.05.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 1134 Protokoli, Datë 18.06.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

NënKryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha

